

MARIA CURATOLO

**FLLAD ËSHTË
UDHËTIMI**

-Poezi-

Biblioteka



Edition IWA BOGDANI

www.iwabogdani.org

iwabogdani@gmail.com

IWA Bogdani, Brussels – Prishtinë

0032494464251

Botues: **Jeton Kelmendi**

Autor: **Maria Curatolo**

Titulli në Serbisht **“Fllad është udhëtimi -**

Përktheu:

Anila Dahriu

Redaktor i botimit:

Engjëll I. Berisha

Dizajni i brendshëm: Bogdani Design

Ballina: IWA Bogdani

Copyright © **IWA Bogdani**

ISBN 978-9951-394-38-3

MARIA CURATOLO

FLLAD ËSHTEË UDHËTIMI



**Bruxelles – Pristina
2025**



PARATHËNIE

Përplasja e parë me poezinë e Maria Curatolo-s ishte emocionuese. Një zbulim i vërtetë.

Ndjeva menjëherë forcën e një personaliteti plot humor, projekte, frymën e ngrohtë të një shpirti që kërkon kuptimin e gjërave dhe është i vendosur të shkoj deri në fund.

Domethënë, ndjeva atë angazhim që me poezinë nuk kalon kohën, por investon shpirtin dhe personalitetin e saj për të gjetur shpresën drejt së pakufishmes, për të mundur dhe kapur fermentet e kohës që kalon aq me nxitim dhe do të donin të mohonin brishtësinë e të jetuarit, të ëndërrimeve, e të dëshirave.

Ky libër i ri, i përkthyer në shqip, me hir e pasion nga poetja Anila Dahriu, pjesërisht mbledh poezitë që kam lexuar tashmë, pjesërisht shton të reja dhe vëren menjëherë një pasuri të shtuar, dëshirën për të dashur të bëhesh e njohur mbi të gjitha për fuqinë shprehëse dhe lirike që zotërojnë.

Maria Curatolo di të mbledh me vargje të qarta dhe shpesh të flakta duke mposhtur muzikën jo vetëm të brendshme të saj aq të pasur dhe të larmishme, por edhe simptomat e gjendjes shpirtërore të shoqërisë sonë, e cila po del jashtë kursit dhe nuk di ku të ndalet.

Ndjeshmëria e Marisë kap dhe grumbullon, por nuk lidhet. Ajo ka dhuntinë e shëmbëlltyrës dhe thjesht Poezi në shqipe.

Di si ta përdorë siç duhet për të na dhënë vargje që kanë thellësinë njerëzore dhe poetike të nevojshme për të çuar përpara një ligjërim të pasur me aspekte, të thellë, të pa



përqendruar kurrë në një notë të vetme, të ndezur nga një pasion që është vërtet forca e madhe e kësaj poezie. Mund të kuptoni menjëherë, siç e kam thënë tashmë në shkrimin tim të mëparshëm, se poetja ka një nevojë të thellë për të komunikuar, jo në sipërfaqen e gjërave, ngjarjeve, ndjesive dhe emocioneve, por me frymë të gjallë në kuptim të fshehur të asaj që ndodh rreth saj dhe brenda vetes. Nuk dua të bëj paralelizëm, po them vetëm se ndjeshmëria e Marisë është e një parashikuese dhe si për rrjedhojë çdo fjalë që përdor kalon në ritmin e zemrës, përmes ngjitjes së dridhërimeve të shpirtit të saj.

Le të ndalemi te temat, me të cilat trajton, por mbi të gjitha në mënyrën se si ajo kap pasurinë e fjalorit për t'i dhënë dritëhije, madje edhe reflektime të asaj që përjeton. Brenda dhe jashtë traditës, të lirë për të lëvizur në pyllin e ngatërruar të fjalëve për të, mund të kuptojmë, me siguri absolute, mbjelljen autentike të rrokjeve, për kapur dhe kuptuar qëndrueshmërinë e shqisave dhe të flakërimeve dhe të dukjeve.

Prandaj, poezia e Maria Curatolo-s përbëhet nga ajo materie e paparashikueshme që ndez qirinjtë e ekzistencës për t'u dhënë ne lexuesve mundësinë për t'u futur në misterin e sensit dhe të misterit, për të udhëtuar në dimensionin e ëndrrave dhe për të përjetuar përjetësinë e të papriturës, ka shkruar një poet.

Shpresoj që dëshmia ime të ketë arritur ta shoqërojë lexuesin në dimensionin në të cilin Maria dëshiron që të jetohet. Nuk është e lehtë, sepse ne duhet të gjejmë harmoni me "Oreksin dhe të bërit" dhe me "substancën e papërballueshme të Misterit dhe Melodisë".



Maria Curatolo

Poezia e Maria Curatolo-s, për të qenë më e qartë, është sinteza e të jetuarit, e rilindjes, e humbjes dhe gjetjes së vetvetes, e zbarkimeve që ofron jeta dhe e përmbledhjeve. Ta ndjekësh kërkon një përpjekje të konsiderueshme njerëzore dhe intelektuale, por ia vlen, sepse atëherë do të mund të shijoni harmoninë e fluturimit, bukurinë e fituar, lirinë e të kënduarit.

DANTE MAFFIA



Më pëlqen dendësia e vargjeve aq kuptimplota dhe e shkruar me hijesi. Lexohen me një frymë duke shpërndarë freskinë e një shpirti të vërtet.

Tek poezitë e Maria Curatolo nuk ka hije dhe të fshehta të trilluara.

Por, janë shkruar më një ndjenjë të pastër dhe të çojnë në një oaz të kthjellët me gjithë ndjesitë e përjetuara. Kush përjeton çaste të tilla në jetë është me fat sepse fjalët shndërrohen nga shpirti për të yjësuar poezinë.

Poezia është si dashuria, përjetohet në të gjitha dimensionet, të bën të vuash dhe fisnikëron jetën.

Anila Dahriu



Maria Curatolo

Poezitë e Maria Curatolo kanë një ton të dallueshëm dhe nuk kalojnë nga një tekst i mirë në një mediokër ose anasjelltas:

Do të thoja që të gjitha tekstet kanë dendësinë dhe melodinë e tyre.

Ritmin e tyre të brendshëm.

Poezi të vërteta, ku dëgjon jo vetëm urgjencën e letërsisë, por dhe një dëshirë të kujtimeve dhe të autenticitetit. Poezi që kanë shënuar ngjarje tragjike, por dhe gjëra të bukura aq të paguara nga jeta. Poezi të kompletuara, të pasura me jetë, dhe ja vlen ti lexosh disa herë.

Daniele Giancane



Nata më e gjatë e vitit

Forca e dashurisë
nuk futet në kafaz
por fluturon...
Arrin majat
vështron qiellin
magjepsëset...
Në atë vezullim
ti e di kush je
ndaj jeto...
Jeto, atje,
ku mendimi të prek
dhe, kërcen...

Gati,
për ta nisur përsëri
lojën.



Alessandra vajzë e vogël dhe e veçantë

Kur brazda e dhimbjes sate
do të bëhet e thellë
mos u largo
jetoje
mbushe me lot
ndërto një urë
do të lë të vendosësh
nëse do ta kapërcesh apo
të qëndrosh.
Ti do të kërcesh
vallen
hapat e tu një melodi do t'i shoqërojë.

Në ritëm do të dëgjosh vetveten
do të marrë krahë për fluturim
në atë çast do ta shijosh
aromën e një ëndrre, madje
do ta jetosh.



Shija e jetës

Ndjekin njëra-tjetrën dhe humbasin
çastet duke anashkaluar kohën
përjetësia e burgosur
në mendimet e sotme
ta rrëfejë një histori
që nuk frymon më
e jeton, madje e humb,
e kërkon
madje nuhat kohën
Numëron hapat
dhe, rigjen gjestet,
fjalët e thëna.
Ktheje vështrimin karshi ditës
teksa ndjek hijen e kujtimeve
jeto.

Magjia mbetet brenda gjumit të thellë
të një jete
mund të ketë qenë dhe nuk është më
karshi harresës së ditëve
zhurma e kambanave
më risjellë te ti.



Pesha e një hije

Humbet gjatë natës
gjuha e dritës
mendime, jo aq të
hutuara të shkrrira
si nota muzikore
e arrijnë qëllimin.
Hëna zbehet
duke të përcjell nëpër ëndrra
pamje e tjetërsuar
loja e hijes.
Dëshirat kontradiktore
përkëdhelin errësirën...
do të të marr për dore
të të çoj drejt të vërtetës.



Luçia

Fjalë
të gërvishtura
Astri e
Kometa
qiejt
përherë
bojëqielli
vështroj
lumturinë time
të shkruar
në një pallat
përballë
vështroj
përballë
në një libër
përrallash
përrallat e mia
ecin
mbi mure
ëndrrat e mia
mbi çatitë
madje fjalët e mia
gërvishtin
yje të rinj
dhe kometat
munden të thonë
një nga një
nën qiellin
e sotshëm
të dua shumë.



E vërteta që nuk mund të fshihet

Ishte mesditë
me zë të ngadaltë
ti më thirre...
Dëgjova rënkimin
e frymëmarrjeve të tua dhe nuk të kuptova.
Duke u lënë të tjerëve, ato çaste
që na ndanë
përgjithmonë!

Por tani do të doja
të jem atje, pranë teje
të të dhuroj atë frymë
që nuk munda të ta jepja:
kur atë kohë njomështake
të gjashtëmbëdhjetë viteve të tua
të mbështolla me një frymë
teksa nuk kishte më zë
dhe u bë shpirt.



Ngjyrat e zemrës

Një rrëmujë në shpirtin e puthur
nga buzët e buta aq të helmuara
as zë pipëtin por një cingërimë e grishur
për ta mbyllur një rreth dhimbjeje.
bë mes të një deti të furishëm
fëmijët e mërguar të Evës përqafojnë agimin.
Të lagur me ujë deti mbartin erë
shëllire
sy hapur
shpresojnë duke u dridhur mes dallgëve
të shkumëzuar për të pluguar
kokrrat e rërës të mohuara
larg sysh ata që nuk mbërritën kurrë
Paqe njerëzve me vullnet të mirë
dhe luftë ndaj atyre që mohuan udhën.

Frika thellë lundron
mbi ujërat që presin në heshtje
ardhjen e Lajmit të Mirë.



Jeta e vërtetë

Zhapiku në diell
guri i pritjes bëhet i kuqërremtë
kërkon hije
gjen dritë
ikën, futët nën dhe
plaga e së vërtetës shërohet
ndër kohë pa lot.

Buzëqeshja gjen paqe
në imazhin e zbehur
të kujtimeve.
Karuseli i jetës fillon sërish
në zhurmën e zërave
tek nuk kanë vesh
të dëgjojnë
tingullin e çudirave.



Kthimi i marinarëve

Lindja e diellit
agimi
dhurata e Zotit
dashuria universale
tek dhuron
jetën njerëzisë.
E mrekullueshme
dhe aq magjepsëse
shtyp dhe fshin
çdo dyshim
mbi madhësinë
dhe pafundësinë
e jetës që rilindë
sajuar nga koha
si një përqafim
bashkon botën.



Kujtimet e fëmijërisë

Ti mbeteshe e përkulur
ndërsa gishtat, gjilpëra dhe filli
ndërthurën
bluzat me rrjetë.

Aq harmonike të përkryera
ishe ti vetë
instrument muzikor.

Melodi e ëmbël
kumbonte
në timin vështrim
magjepsje foshnjore.



Ajo

Ec, vajzë
përschëndete ditën
kurrë mos u dorëzo.
Gjatë rrugës
do të hasësh hendeqe dhe muzgje
kurrë mos u dorëzo.
Vështro larg
drita depërton
kurrë mos u dorëzo
pezmi mos të të lëndojë
mbliidhi lulet në lëndina
le të vijë udhëtimi tek ty
të shohësh vetëm vezullimin.



Nga kjo tokë

Homazh për Kalabrinë

Në këngën e sirenave
dëgjon rrahjen e zemrës
të Mesdheut.
Madje, e quajnë Jug
të Italisë,
takimi midis agimeve të kthjellëta të Jonit
perëndimi vëllazëror i Tirrenit.
Tingulli i kambanave të mesditës lajmëron
një Evropë si pulëbardha në fluturim
kërkon atë fole që nuk u gjet kurrë.

Nga kjo tokë e lashtë
ngrihet e fortë
aroma e luleve të portokallit
era e flladit të detit
aroma dehëse e limonave
thërret popujt dhe vendet e largëta
në një mesazh dashurie.



ORË BLU
(koha, hapësirë blu)

Orë blu kobalt
ngrihet e shkrinë litarët të ndrydhur
copëza jete
shko, peshkatar
lundro nëpër dete paqeje
uji është i qetë
Bota është e sëmur.



Emocion

Në shkëlqimet e para
pas një nate mbytëse
gjejë lulet e mia
përsëritet detin
unë me to përkulem.



Baba

Në shtratin tim të ngrohtë
dëgjoja zërin tënd
si një lajmëtar
Giuse, Nico' Anto
shkojmë drejt detit është i qetë.
Kur kthehem jemi të qullur prej tij
vetëm arkëza me sardelet është fitore
e fituar me një forcë aq të lodhshme
madje aq emocionale
ndërkaq zgjon kujtime të lashta
të një toke të premtuar në çdo nisje
madje, është, atje shenja tek përkundet
vështrimi tek përkëdhel mendimet
në atë dhomë të hapit të flakët
e qiriut të shuar.



Do të doja

Do të doja të kompozvoja lirikën time
me kujet e qenit tim
do të doja të lija mendimet e mia
të shpërndara në dhomë
duke kompozuar një melodramë.

Do të doja një mrekulli të më përqafoj
me krahë hapur duke më shtrënguar fortë
do të doja të lija buzëqeshjen time
nëpër rrugët e lodhura nga shekujt
do të doja të harroja që indiferenca
është maska e cila ka kthyer ëndrrat e mia
në shelgje tek derdhin lot.



Një çast

Një çast
humbëm
rruga ishte e gjitha aty
përpara nesh ajo puthje
marramendje e trupave tanë
në ajër të mpirë
të mesditës
ishte shenja e ndritshme
e misrit të pjekur
tashmë jemi në një kthinë
të lëndinës në pritje të rënkimeve
një dhuratë
një përkëdhelje
me magjinë e frymëmarrjes tënde
brenda të çdo krisje të zemrës
nga një gjumë i thellë.



Shpirti

Nëna ime përherë në zi
dhimbja si një flakë në gji
fryma e vëllait tim shndërruar në shpirt
me dëshirën të iki diku.



Kënga e lutjeve

Më habit
është zjarr që djeg
më mbaj
është kënga e lutjeve
qarja
e ëndrrave të veshura me hiçin
zbrazëti
përreth erës guximtare.



Ajo është

Është një çast
një zhytje
në det që përqafton
një ditar mbi buzë
një dolli në mesnatë
ajo është.



Të braktisa kohë

Të braktisa kohë
emocionet e qepura mbi shpatulla
në të zezën e veshjeve të mia
arnuar zemrën
ti jeto shkëlqimin tënd
do të jesh vashëza dhe grua
hap pas hapi do të përjetosh
madje, dhe dhimbjen
vesh me të papriturat
madje, jeto dashurinë.



Puthjet

Ah...puthjet e qëndisura me afsh
të lumtura ditët që kam përjetuar
të gjata, udhëtime
monopate mendimet
teksa tingëllojnë ëmbël
gjithçka si çelik i ri.



Në Marinë

Orë blu
mbi ujërat jonike
ngatërron vështrimin
dhe marinarët.

E përgjumur në Marinë
llamba në qiell
rikthen itinerarin.

Lundruam në vijën e drejtë
midis Capo Spulico dhe Capo Trionto
ishte shkumë e bardhë
e vrullshme.

Kërkuam mbërritjen
por toka u ishte
mohuar
në shtratin e detit
tani gjendet historia.



Rrënjët

Rrënjët
rikthehen për t'i lënë hapësirë vetes
madje ecën nëpër histori
unë jam në heshtje nëpër
kujtime
për të rrëfyer për jetën dhe për
dashuritë
në lëmshin e fytyrave kam rilindur
e vërtetë
marr guxim
djersisë,
shikoi krenarinë e një pamje
të re
ditët e tyre jashtë këtij
imazhi
vështirësi në çdo rikthim
duart nuk ndalen së gjeneruari
shpresë
gratë bartëse
bujare
burrat tregojnë historitë e tyre gjatë natës
stuhi
duart e gjyshërve të prekin
ëndrrat
Fëmijët tek kanë frikë të dëgjojnë
përralla
me dragonj, ujqër, lakuriq nate dhe
shtrigat
dhe në magjepsjen shihen përsëri
rrënjët.



Kështu jam unë

Unë nuk jam pemë kristali
as folja e shfrytëzuar në mendimet
e mia
nuk jam ai dyshimi i frikësuar
as dega e zbehtë e thyer
jam karta e fildishtë
një mijë vena në gojën time
jam shkretimë për vdekjen time
burim që flladit kohën time
kështu jam unë...



Grua

Virgjëresha e Shenjtë
pa mëkuar
ku gjendet mëkati
në dhembjet e gruas
Penelopa
qëndisi dhe shkatërron përsëri
gërshetimin e fijeve
të përhapura
nëpër mashtrimin e kohës

ti gruaja ime e
kohës
hiqe letargjinë
hidhe budallallëkun
idiot
mentalitetin e vjetër
ndër shekuj

hyr dhe gërmo rrugëtime ndër rrudha
të dhëmbëzuar

kërko sytë e të shqyer
qëndis
fjalë për mua

bërtit gëzohu
kënde të gdhendura
tek mbulojnë ijët ligjëruese
prehrit në pritje.



Kush jam unë

E kam zemrën bujare

përbushur plotë me të tjerë
notojnë mendimet
në një det tek i përshkon
rikthen përsëri atje.

Përsëri gjej shpresën
e shpërndava përgjatë ditëve
të një jete të mbështjellë dhe
e mbushur me zbrazëti.

Truri im si një barrë
delikate
e çmuar dhe e bezdisshme
duhej të paketohej
– vëmendja e brishtë –
edhe pse tani diçka
dhe dikush në këtë botë
më konsideron mjaftueshëm
të fuqishme
të më godas me grusht në kokë.

Por unë nuk jam në kurth dhe aq e
dobët
gërmoj në hendekun e kujtimeve
dhe e gjej vetveten si më parë
ndërsa unë kërkoj vetveten
kush jam



vishem me dridhërima
dhe dëshiroj.

Më pëlqen të më dëgjojnë.

Më pëlqen të dhuroj fjalë
dëshiroj dridhërimat të kthehen
si lajm... jo në pazar
kaq mjafton
shumë gjëra, po
shumë gjëra janë të gabuara
tashmë e kanë krijuar dramën.

Maria që stoliset me një
pardesy konfuzioni
i padepërtueshëm dhe i respektueshëm
dhe fillon të mendojë marrëzi
e vetmja gjë që di të bëj.

Ja ku jeni!
u krye:
Unë, ata, dhe pastaj përsëri unë
tek përziej kartat
dhe filloj të luaj përsëri
nuk di të mashtroj
dhe fundosem
në një faqe personale
që nuk shitet
si të thuhet elektrokardiograma.



Autoportret i ashpër

Jam e pangopur
bëj pa gjumësi, por jo pa çokollatën time
janë të paqëndrueshëm librat e mi
rrinë të hapura për një kohë të gjatë
duke më shikuar
jam aq e brishtë
në dashuri, madje përherë lë pas një nyjë të gjakosur.

Nëse do të isha Zoti, nuk do ta falja veten
i rrëfej mëkatet e mia dhe
do ta bëj sërish
jam dembele
në shtrat mbetem e lidhur si qeliza të vdekura
kjo është letargji
duhet të kem guximin të debatoj
duhet të kuptoj
ndërkaq jam e pambrojtur
nuk duhet të tallem me
veten time
nuk duhet të mbart më ëndrra të kota.



Kujtime familjare

Era e kripur e detit
zëvendësonte përqaftimet të pa dhëna kurrë
gëzimi i lidhur me kthimet
e papritur dhe e fundosur në det
e dyta nga nëntë fëmijët
isha një grua dhe një foshnjë
kopanec i vogël me rënkimet
prishte gjumin
ishte syth
çdo jetë e re
të qara pa pushim
kukulla që nuk kam pasur kurrë
bukë e njomur në qumësht
mëngjesi
në filxhanin e bardhë të rrumbullakët
rrobat e mia mbartnin parfumin
e duarve me imagjinatën
e gjyshes
qëndisje të endura të jetës së re
koha që shkonte.



Kolltuku i kujtimeve

E veshur me kadife blu
mbretëreshë në dhomën e pritjes
mysafirët nuk guxojnë t'ju prekin
as nuk i shtrijnë gjymtyrët
të këqyr mbrapsht
shoh stër-stërgjyshër dhe jaka të ngrira
por heq dorë
dhe zhytem në kolltukun tim të butë liri
ndërsa ti flirton
me triptikun e argjendtë
dhe të shfaqen
kujtime kurrë pa u zbehur
të çajit në çajnikët e Limoges
tani për të lënguar
dremitur në tryezën e rumbullakët
dhe unë pi kafën
në gota dhuratë me kursimet
e shpenzimeve.



Fëmijëria ime

Përparësja e bardhë me një lule të madhe
dy krahë të fortë tek më bëjnë të kthehem
ditë të ftohta në Borgo Marinaro
erë e fortë dhe stuhi e frikshme
varka në mes të detit
fëmijëria ime rreth mangallit
duke u përvëluar
xhaxhai im plak që rrëfen përralla
aroma kripe dhe qumështi
me shumë bukë të mirë
nëna ime pranë ngrohjes
peshk për çdo gjellë

babai im në det
me mungesa të gjata
gjyshi nga nëna dhe librat e t'ia
në valixhen me karton nën krevat
tre musketierët të Dumas diktimi im
gjyshja ime nga babai
me aromën e salcës më zgjon
nga lojërat e rrugës dhe gjunjët e gërvishtur
verës rrezet e diellit na përcjellin
në breg të detit duke mbledhur guaska
me kostum deti
nga mëngjesi në mbrëmje
fëmijëria ime vështrim mbi të mëdhenjtë



me dëshirën për t'u rritur.
Vëllai im me dëshirën të lexojmë së bashku
ulur në karrige dhe aq e gjerë sa një tavolinë
fëmijëria ime
ikja ime nëpër rrugë
loja me pesë gurë
dhe aftësia të qëndisja tek murgeshat
pajën në lino
me dantella dhe zogjsh
tashmë hedhur në sepete.



Nënë

Nëna ime...

e pikëlluara tek shikon frymën e tre fëmijëve
tek u bënë shpirtra
nëna ime i ngatërron emrat e nëntë fëmijëve të vet.

Nëna ime në dhomë në Borgo Marinaro
mbante erë gjelle dhe nuk e kuptonte
se unë isha e papërmbajtur
nuk e duroja dhe ikja
ajo më godiste me shapka në vend që të më fliste.
Nëna ime nga një Milano gri
me tumorin e saj në bark.
Kisha frikë për ta sjell në shtëpi
më duhej të merrja avionin
kisha frikë nga lotët e saja që nuk i kuptoja
kisha frikë nga rrobat e saja të zeza, përherë në zi,
kisha frikë nga vështrimi i saj i brengosur
kisha frikë nga zgjuarsia e saj,
nga një metër e tetëdhjetë të trupit të saj,
kisha frikë nga duart e saja të mëdha dhe punëtore,
u frikësova nga heshtjet e saja,
kisha frikë dhe u largova.
Dëshironte të isha studente
për ato lot që unë studiova...
madje studiova shumë
dhe vazhdoj akoma të studioj,

Fllad është udhëtimi



e ndjej fortë në gjoks
akoma më rrjedhin lotët në fytyrë
ende ndjej dhimbjen e saj
në netët pagjumë.



Do të doja kujtimin

Do të doja të kujtoja babanë tim si djalë
rrëmon në shportë për një copë bukë
do të doja kujtimin
e puhizës së detit tek e përkëdhelte
në ditët e peshkimit jashtë Gjirit të Tarantos.

Do të doja të kujtoja një trëndafil që ia dhuroj nënës sime
kur ishte 16 vjeçe
do të doja të kujtoja se kisha dëgjuar KRISHTIN
kur i largonte tregtarët nga tempulli.
do të doja të kujtoja emocionin e Borges-it
teksa kompozonte Elegjinë e kujtesës së pamundur.
Do të doja të kujtoja Monet-in,
tek pikturoi Shëtitoren e Shopenit,
i cili kompozoi veprën Nocturne 9 Nr.
e Kavafis teksa rilexonte Itakën e tij.

Do të doja kujtimin
nga lavditë e Sybaris legjendar
të mrekullisë së vallëzimit në maska
në Sallën e Pasqyrave të Kalasë Dukale të Corigliano.

Do ta doja kujtimin
e turmës së tregtarëve në “Palazzo delle Fiere” në
Schiavonea.
Do të doja t’i kujtoja puthjet që i dha mamasë sime
për 18-të vitet e saja rinore
dhe rrahjet e zemrës së saj
për puthjen e parë në ballin tim.



Treni jugor

Mbërrin diku tjetër dhe i prenë rrënjët
në zemër imazhet e humbjes dhe të ndarjes
njeriu i jugut hipur në tren
gjurmët e jetës të ndara
ndër duar mbetet dhe është historia e dhimbshme
e pritjes së njerëzve të katundit
nyja lidhëse qepte valixhen e kartonit
ëndrrat hapën udhë, lundruan
trenit jugor
fëmijët tanë mes karrocave dhe
kompjuterat vetjak
kapërcejnë barrierat emocionale,
arrijnë shpresat me veshjet e tyre të reja
dhe në kthim të hapave të tyre
nuk do të ketë asnjë kujtim.



Qyteti im

Corigliano-Rossano është një bukuri e mahnitshme
që nga deti deri te aroma e flladit
Corigliano-Rossano në ujërat tua, të Jonit
mbështeten shpresat e lashta
Corigliano-Rossano detin tënd të bukur
ne nuk mund ta çmojmë
Corigliano-Rossano që ishte Magna Greke
na përqafo me mençuri
Corigliano-Rossano Piana di Sibari portokallet e
harruara,
klementinat, ullinjtë shekullorë, qyteti i dashur
Corigliano-Rossano me Kështrellën Dukale historia
jote.

Codex Purpureus, Pathirion, Katedralja
Corigliano-Rossano vend bregdetar me det të
stuhishëm,
shijen të hidhur Corigliano-Rossano
fëmijët e tu larg, ëndërrojnë të kthehen,
shtrëngoji me duart e tua
Corigliano-Rossano, qyteti i gërmuar,
bukuria që të përmbledh,
Corigliano-Rossano gati të rishkruajë historinë,
na jep kurajë, dashuri dhe kujtesë.



Netët

Janë dridhërima,
nuhatjet të rrëmbyera nga sytë
mbeten maska të ditëve me përgjërime
me duar të shtrënguara pa ëndrra
mes mureve me zinxhirë
netët
rrëfejnë të vërtetën.



Kënga e lutjes

Më befaso
është një zjarr që digjet
më përmban
është këngë lutjesh
qaj
ëndrra e veshur me asgjë
zbrazëti
përreth guximit të erës.



Të çuditur dhe të lirë

Hap pas hapi
një ecje e shpejtë
midis baticës dhe zbaticës,
hapësira mes nesh
të habitur dhe të lirë
fundosemi atje
ku gjithçka pezullohet
midis vorbullave të mendimeve
një shqiponjë në fluturim
thelbi ynë.



Ajo është

Është një çast
një zhytjeje
në një det që përqafton një ditar
një dolli në mesnatë
është ajo.



Binarët e gjelbër

Binarët gjarpërushe mavi
dhe jeta ime është në rrezik
kam flori në gojë
dhe dhëmbët kërcëllim
zhurmshëm do të prekin binarët
gërvishtin gjumin tim
shqiponjat përgjojnë
një fole mynxyre
i jep jetë përhirit tim
gërhiq litaninë e vargjeve
kanë vjedhur notat e kohës time
nuk e gjej uvulën (bajamet) të këndoj
por do të mbërrij në kohë
do t'i shqyej gjarpërinjtë
në orët e shuara.



Për Emily Dickinson

E thjeshtë dhe e vogël,
ti rrëshqet mbi vete dhe mbetesh brenda
atij, altari fjalësh
të lindura, të gjalla
me të cilat zbukurove kohën,
shkëmbinj apo rërë të gjallë,
vështrimi yt,
një mister që u bë
çelësi i të gjitha dyerve,
një fanar që gjurmoi horizontin
e mendimeve të tua
madje, i bëri të fluturojnë në qiell
feks në rrjedhat e ekzistencës
rreze të vetvetes diku tjetër.



Mbi kodër

Kuaj në këtë turbullim
mbi lëndina qilimash të jeshilët
të mbuluar me dëborë
shikojnë tufat e zogjve të zhurmshme
tek largohen
përreth fluturonin zogj të egër të paqme
shkaktuar avuj të rëndshëm
rrathë pezull në ajër
duar të ashpra kadifeje përkëdhelin
kurorën e artë
drejt mbrëmjes një mendim lehtështypës
rëshqet mbi supet e një energjie të mekur
thërriste
çastet e gjumit në zgjim
momentet e lumtura po aq të mjeruara
përfunduan ditën.



Po të lë kohën

Po të lë kohën
edhe emocionet
të qepura gjithkund
me të zezën e rrobave të mia
arnova zemrën time
ti jeton shkëlqimin e saj
do të jesh vajzë dhe grua
hap pas hapi
do të përjetosh edhe dhimbjen

ti vishu me çastet,
jetoje dashurinë.



Dhe transformohet

Asgjëja e pamasë
transformohet
për të lënë pas
kujtimet e lashta
dhe më në fund
të mbërrij te ju,
ndalet mendimi
apo hija jote ngelet
madje shkrihen të gjitha fijet e dhimbjes
të gjitha gërvishtjet e kryqëzuara
si bora e lirë do të heqin dorë,
e lirë do të kapërthej
dritën e mëngjesit
të dhuroj krahët
dhe përqafoj mendimet.



I ndjej

I ndjej në përqafimin tënd
dridhërimat dhe ritmet e shkëputura
madje, humbas këtë zë të shurdhët
të vargjeve melodike,
i ndjej mendimet e vështira
kujtime përplasje sysh
e njoh mirë farsën (komedinë)
e megjithatë ndihem e gjallë
si një fantazi që më përshkon
dhe zbut telat e shprishura
në heshtjen e syve
ndërsa mendimi të ledhaton
dhe gjendesh përsëri.



Fjalë të pezulluara

Lexuam së bashku në një mbrëmje
dimri
zjarri në oxhak flakëronte
trupat
zëri yt depërtoi luginat
rrugica kurrë përshkruara
dhe ëndërruar
çdo gjest e çdo fjalë
krijuan kujtimin që tashmë e mbledh
në ditët e ngjeshura tek lulëzojnë
dhe ti si pendë bie
dhe më ndihmon
për të ndërtuar
kështjella të magjepsura
mbrëmjeve të verës
zëri yt refren
dhe shtrihet në majat e një lëndine
të mbuluar nga frymëmarrje mbytëse
të kërkoj atje
ku vazhdoj të dëgjoj
fjalë të pezulluara.



Mungesa jote

Bojë e dëlirë
mbi çarçaf të bardhë
mungesa jote
ajo copë qiell
në paqe të trazuar
po pret.



Haiku

Kërkova dritën
e vulosur në tempull
gurë të diellit –
mblodha ar dhe kujtime
mendime për trurin

Kripësia tashmë
midis baticës dhe zbaticës
na strehon
në refleksin e blertë
që fshin të kaltrën

Era fryn
drejt natës fal
varka nis lundron
pulëbardhat rrëshqasin
kërkojnë folenë

Gjeli këndon
në një ditë të gjelbër
me erën tënde.

Gur dielli
tani gjurmo jetën
fjala qoftë.



Petunia rozë
përkulet para detit blu
mirëmëngjesi verë.

Përkulur para diellit
Dimrit rigjetur
binte borë.

Fëshfërima e degëve
era fishkëllen
ditë e mugët.

Fle natën
nën pjeshkën e lulëzuar,
duna shkëlqen.



Kam Parë

Kam parë të mërguarit, fëmijët e Evës
tek prisnin të picërruar në mes të detit
djallin e radhës.

e kundrova njeriun dhe u vesha me inatin
e kam parë euron të mbërthyer
në fustanin tim të bardhë dhe heshta
pashë një dragua, gjashtë dragonjë të gjithë Cucuzzaro
shikoja katranin (pisllekun) në jakat e tyre të bardha
dhe ne që largoheshim
shikonim!

Dua idealet e mia të gozhdohen
në një vijë vertikale dhe horizontale
– Krishti në kryq –

Dua të shoshit gjithë rërën
dhe zemërimin tim pas pyetjeve parlamentare.
Dua një dekret të kryeministrit
që i vendos burrat në radhë për t'i vaksinuar
kundër metamorfozës së idealeve
dua!

Të ndërrohen pardesytë.
të ndryshojnë udhë.

Madje, presjet në pika
ndryshim!

Jam e mundur në 160-vjetorin e bashkimit të Italisë.
Mbetem e mundur!

Mbetem me vargjet e mia të shtrira në breg
po përqafoj valën e revolucionit!

Cucuzzaro(lojë që ndeshet në jug).



Jam Sisi

Dielli përvëlues i gushtit më
çon drejt bregut
hedh vështrimin rreth e rrotull
asnjë frymor poshtë çadrave
sakaq shtrihem mbi shtrat
jam lakuriq
e ndiej trupin tim...pelush
kam turp
prek litarin
ja kjo është veshja
ndërkaq mbërrin një nënë me foshnjën e vet
tek ndalon dhe afrohet
kërkon të më përkëdhel
por ka frikë ...frikë!
Nga goja ime e shqyer
nga veshët e mi të mëdhenj
nga thonjtë e mi të përthyer
fiksoj sytë e saj pishë ulliri
dëshiroj përkëdhelje
madje të shtriqem dhe të lë pihem
një britmë e gruas mbërrin
Leo largohu është një qen.

Nuk e dua veten më dhe ndërkaq
ulem mbi rërë
çapitem zvarrë, kam etje
dielli i gushtit
thërret njerëzinë
nuk më interesojnë.

Unë Sisi leh
Ham...Ham...Ham!



Krishtlindje 2020

U shembën kështjellat e magjepsura
luftova me grushte me kohën
ballë për ballë me vdekjen
brenda meje
frikë
hutim
një jetë e jetuar dhe e pa jetuar
pa to
Alessandra dhe Martina
mbetën të gozhduar
në Lago Maggiore
mes rosave të egra
unë me fluturat në tarracë
asgjë nuk zgjatet përgjithmonë
dhe 2020
m'i mblodhi dhimbjet e mia dhe iku.



Krishtlindjet dhe kështu qofshin

Nuk është e jona kjo kohë feste
dëgjoj pëshpëritjet dhe jetoj
pemën plot dhurata të dëlira
tashmë të shtrira lënë në bodrum.

Kërkoj gjurmët e hapave tona të dashura
gjej parfumet pafund
do të jetë një Krishtlindje e kufizuar
janë imagjinata mendimesh teksa fluturojnë
në mendjet tona vetëm aroma
do të jemi me zemrat tona,
atje, në shtëpi.



Odë për vendin e shpirtit

A nuk janë lindjet dhe perëndimet e diellit
magjepsëse
dhe nëse nuk i sjell në shtëpi
shpirtrat e mbartur dhe të veshur me shpresë të
përvëluar
nga dielli i gushtit
harro, fal ngrohtësinë e tij,
të lashë goxha flakë në oxhak
por të gjeta mes zjarreve të pasigurta
të dashurive të mia
vendi im bregdetar Schiavonea
të mohova njëqind herë
dhe prapëse njëqind herë të kam kërkuar,
të kam njohur ndër shqetësime
ndër mendimet, mes njerëzve nëpër rrugë
në ulërimat e qytetit të Bruzi
ëndrrat e mia flenë
të mbuluara me ujë deti
tashmë mbrapa nuk dua të kthehem
një qind herë të kam mohuar
madje një qind herë të kam gjetur
me gratë në shtëpi
dhe shpresat e varura
vend gënjeshtar dhe sakaq i vërtetë.



Odë për detin

Të kërkoja nëpër rrugicat e qyteteve
në dashuritë e mohuara
ishe frikë
vullnet për të ngadhënjyer,
kalova nëpër përkundjet e jetës
duke ndjekur udhën
teksa rrahjet e zemrës më kthenin te ti,
shikova dritën në një mijë nuancat e tua të kaltra
me një zinxhir më lidh
tani më jep këngën e mijëra sirenave
të diellit që djeg lëkurën
çdo cep të jetës sime
është prehër në duart tua.



Odë për makaronat me sardele

Nga lëkura e argjend e mishit tënd
kokën dhe halat i heq
ngelet trupi lakuriq
dhe unë me ty zhvishem
nga ankthet dhe gjej
rikthimin e tim Eti
nga një natë e gjatë mes detit
përball lamparës
nën shkëlqimin e saj vezullues
akoma të paziera makaronat
përmbledhin gjymtyrët e tu të argjentë
me shumë domate dhe dromcka buke
aq të shijshme
tigani tek i mbledh i hedh përpjetë
vallëzojnë
në një këngë të shijshme dhe kënaqësie.



Odë për mandarinat

Të heqë lëkurën, të shtrijë
dhe të shijojë,
rrezaton dielli
dhe dallgë në mes të qiellzës,
ushqehem me çaj në mëngjes,
kuti e artë me biskotat e mia,
nektar hyjnor
nga rrafshi i Sibarit,
je ar,
mbërrin nëpër tregje anembanë vendit
je kënaqësia, je tokë e jugut.



Odë për kaktusin

Ylber ngjyrash
mullagat në parvazet e mia
një dorë budallai i shkuli
e zhgënjyer nga ky udhëtar i çuditshëm
në vazot e dëshpëruara në parvaz të dritares
mbolla kaktusët pa hezituar
kur të kthehet udhëtari dinak
do të zhgënjehet,
dhe nuk do të guxojë t'i prekë
tashmë triumfues i shfaqet jetës
këmbëngulës në muzg
rezistojnë nëpër rrugicë.



Odë për teoremën e Pitagorës

U përpoqa
të thyeja çdo anë të kohës sime
shumëfishova luginat e kujtesës,
fëmijërisë dhe rinisë,
e gjeta vetveten
si një teoremë euklidiane,
jeta brenda meje
e dija përherë që babilonasit
kur Pitagora vëzhgoi
pllaka katrore dhe i prishi
duke kërkuar zonën nga katetet
dhe formulat logjike të hipotenuzës
që mbaj brenda pritshmërive të mia,
kërkova zgjidhje
rizbulova bukurinë
e vendeve të mia të shumta.



Odë për Italinë

E vërtet në mendjen e atyre e bënë
dhe mbetet e vërtetë në sytë e fëmijëve
në parqet multietnike
e vërtet për të përballuar dhimbjen
e kësaj kohe të stuhishme
duke pritur të kthehen
bijtë e saja.
e vërtetë në sytë e të rinjve në arratisje
e vërtetë në aromën e luleve të portokalleve në jug
e i vërtetë trupi yt i përdredhur
e pikturuar nga puhiza e detit
e vërtetë është bukuria e kodrave të tua
që mbrojnë kufijtë
sa e vërtetë dhe nënë je ti.



Pasthënie

Këto vargje të Maria Curatolo-s i kam përkthyer me shumë pjesëmarrje. Ndjeva që bota e saj është shumë e ngjashme me timen, mendoj që ajo që shkruan është pasojë e drejtpërdrejtë e veprimeve të saj, e të qenit grua në plotësi totale.

Parathënia e Dante Maffias do ta sqarojë më mirë këtë ndjesi timen tek lexuesi. Por duhet thënë se në përkthim kam mundur të vlerësoj plotësinë e një diktimi poetik që ka shtresa fijesh delikate me përjetësinë, me pasurinë që është një trashëgimi e lashtë dhe që Maria ishte në gjendje ta kuptonte në thelbin e saj dhe në dimensione të pamasa.

Vitet e fundit kam intensifikuar punën time përkthimore dhe kam bashkëvepruar me shumë poete dhe poetë. Personalitete me rëndësi të ndryshme dhe gjithmonë të pasura, por me poezinë e Marisë lidhja ishte më e dendur, më e fortë, deri në atë pikë sa të ndieja pothuajse aromën e fjalëve të saja. Më duhet të them se tek Maria Curatolo e gjejmë praninë e një personaliteti që shkon përtej mënyrës së saj të zakonshme. Ajo ka brenda shpirtit të saj flamurin e lirisë, fitoren e dimensionit poetik si fakt të natyrshëm.

Ta lexosh është si të hysh në një pyll të dendur me pemë, por të ndiesh që ajo di të lëviz rastësisht sepse ka krahë dhe aftësinë të fluturojë. Megjithatë,



nuk ishte e lehtë të zotërohej menjëherë këtë aspekt, vargjet nuk iu dhanë lehtësisht gjuhës së re, sepse ishin shkruar, do të thoshte Maffia, të farkëtuara në mënyrë të lirë, thelbësore, mbi valën e afinitetit me trazirat e jetës. Dhe, nuk janë të prirura menjëherë të bëhen një gjuhë tjetër, një tingull tjetër.

Por poezia e vërtetë gjithmonë gjen rrugën e saj drejt kuptimit të ri dhe vendosët në muzikën që sapo ka dëgjuar, ndonëse me variacione të vogla nga origjinali.

Me pak fjalë, poezia e Marisë ka një zë bindës dhe të ri që ka nevojë për dashuri për të mos humbur forcën në një fjalor tjetër. Dhe unë gjithë këtë dashuri e vendosa në të pikërisht jo vetëm për të dhënë dimensionin e saktë të vlerës së saj, por edhe për të treguar forcën e re dhe të vërtetën që buron nga zëri i saj.

E thënë thjesht, poezia e Maria Curatolo-s nuk është e imja, madje është fatkeqësi nëse nuk e dashuron dhe nëse nuk e pranon në thjeshtësinë dhe dëlirësinë e diktimit të saj.

Ne nuk jemi në frazat e zakonshme të lidhura ende me shprehjet e shekullit të nëntëmbëdhjetë, te Maria ekziston patosi i gjallë i dikujt që nuk lë pas dore asgjë në çdo takim, ekzistojnë rrahjet e zemrës së jetës, aty është pikërisht dhimbja e atyre që nuk kanë mundur të fshijnë shëmtinë e jetës dhe mbi të gjitha është përkushtimi për të rinovuar kuptimin dhe formën.



Maria Curatolo

Një projekt tashmë në zhvillim e sipër, synimi i një bukurie dhe vargjesh që të çojnë menjëherë në zemrën e një udhe të hapur që ngjitet drejt yjeve...

ANILA DAHRIU



Biografia

Maria Curatolo u lind në Corigliano Calabro (CS) ku jeton tashmë. Ka punuar si fizioterapeute. Kultivon pasionin për të shkruar prozë dhe poezi. Preferon poezinë pamore. Redakton rubrikën “Tregimet e shpirtit” të revistës dymujore “MONDIVERSI” të Corigliano-Rossano. Jep kontributin e vet në shumë shoqata të ndryshme social-kulturore të qytetit Corigliano - Rossano. Puna e saj është dhuratë për të tjerët si në procesin e rritjes personale dhe kolektive. Përgjegjëse për "Laboratorin e Gruas" të shoqatës Mondiversi, kujdeset për recensionet të letërsisë " Lexime në katund “me autor të ndryshëm” Të shoqatës Schiavonea dhe Sant'Angelo Pullit.

Vazhdon rrugëtimin e saj të brendshëm si në shkrim ashtu edhe në frymëzime poetike, gjithmonë në kërkim të stimujve të rinj. Bën pjesë në komunitetin e Universitetit të Poezisë "Juan Ramon Jimenez". Është e pranishme në historinë e revistës dyvjeçare të letërsisë “La Vallisa”, gjithashtu të drejtuar nga Profesor Gianccane, dhe një seri tregimesh surreale, si dhe "Përrallat e shpirtit". 2009. Kjo është antologjia e saj e dytë.

Përgatiti dhe shqipëroi ANILA DAHRIU



Përmbajtja

Nata më e gjatë e vitit.....	10
Alessandra vajzë e vogël dhe e veçantë.....	11
Shija e jetës	12
Pesha e një hije.....	13
Luçia	14
E vërteta që nuk mund të fshihet.....	15
Ngjyrat e zemrës	16
Jeta e vërtetë	17
Kthimi i marinarëve.....	18
Kujtimet e fëmijërisë.....	19
Ajo	20
Nga kjo tokë.....	21
ORË BLU	22
Emocion	23
Baba.....	24
Do të doja.....	25
Një çast	26
Shpirti.....	27
Kënga e lutjeve.....	28
Ajo është	29
Të braktisa kohë	30
Puthjet	31



Në Marinë.....	32
Rrënjët.....	33
Kështu jam unë.....	34
Grua	35
Kush jam unë.....	36
Autoportret i ashpër	38
Kujtime familjare	39
Kolltuku i kujtimeve	40
Fëmijëria ime.....	41
Nënë.....	43
Do të doja kujtimin	45
Treni jugor	46
Qyteti im	47
Netët	48
Kënga e lutjes	49
Të çuditur dhe të lirë	50
Ajo është	51
Binarët e gjelbër	52
Për Emily Dickinson	53
Mbi kodër	54
Po të lë kohën.....	55
Dhe transformohet.....	56
I ndjej	57



Fjalë të pezulluara.....	58
Mungesa jote.....	59
Haiku	60
Kam Parë.....	62
Jam Sisi.....	63
Krishtlindje 2020	64
Krishtlindjet dhe kështu qofshin	65
Odë për vendin e shpirtit.....	66
Odë për detin	67
Odë për makaronat me sardele	68
Odë për mandarinat.....	69
Odë për kaktusin.....	70
Odë për teoremën e Pitagorës	71
Odë për Italinë	72
<i>Biografia</i>	76



Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

821.131.1-1

Curatolo, Maria

Fllad është udhëtimi : poezi / Maria Curatolo ;

përktheu Anila Dahriu. - Prishtinë : IWA

Bogdani, 2025. - 82 f. ; 20 cm. - (Biblioteka”Adp

1. Dahriu, Anila

ISBN 978-9951-394-38-3

